

Institucioni Raportues			Ministria e Arsimit dhe Sportit	
Periudha e Raportimit			JANAR-QERSHOR 2025	
Numri i Masave për tu raportuar		3		
Qëllimi i politikës C: Arsim i lartë gjithëpërfshirës që përmbush standardet ndërkombëtare të cilësisë, integritetit akademik e transparencës dhe është promotor i zhvillimit ekonomik dhe shoqëror të vendit.				
I	Objekti i specifik C1: Rritja e cilësisë së arsimit të lartë përmes riorganizimit të programeve të studimit, modernizimit të infrastrukturës akademike dhe zbatimit të standardeve të larta të vlerësimit institucional dhe të programeve të studimit.			
Nr.1	Masat	Afati Kohor	Rezultatet e pritshme	Indikatorët
1	C.1.1 Programet e IAL-ve ndërtohen mbi rezultatet e të nxënësve dhe janë të krahasueshme me programet e IAL-ve evropiane.	TM2 2023-TM2-2024	C.1.1.3 Realizimi i kodifikimit të programeve të studimit.	Kodifikimi i programeve të studimit të ofruara nga IAL, fushat 1, 2, 6, 7,
	Raportimi mbi zbatimin e masës :			
	Arsyet e moszbatimit (në rast kur masa nuk është zbatuar)			
	Raportimi Financiar			
	Shpenzimet/Alokimet		Buxheti i shtetit	Donatori/ët
Shpenzimet financiare				
Alokimet e pritura				
Rekomandime:				
Nr.2	Masa	Afati Kohor	Rezultatet e pritshme	Indikatorët

2	C.1.2 Përmirësimi i infrastrukturës akademike.	TM1 2021-TM4 2026	C.1.2.1 Investime në zgjerimin dhe përmirësimin e infrastrukturës akademike (godinat, kampuset, laboratorët, bibliotekat etj.)	Numri i godinave ne perdorim / pronesi te UV. Numri i sallave audio-vizive per															
	Raportimi mbi zbatimin e masës																		
	C.1.2.1 Per periudhën raportuese Universiteti "Ismail Qemali" Vlore, ka përmirësuar investimet të financuara nga të ardhurat e veta të UV-së si : 1. Blerje inventar ekonomik 540,000 lekë. 2. Ndërtimi i shkallëve të emergjencës në vlerën 11,255,648 lekë. 3. Blerje paisje laboratorike 992,551 lekë. Nga donatoret e huaj, si rezultat i zbatimit të Projektit me Financim të Huaj "ZERO UV" janë blerë paisje laboratorike në vlerën 4,962,555 lekë.																		
	Arsyet e mozbatimit (në rast kur masa nuk është zbatuar)																		
	<table border="1"> <tr> <th colspan="4">Raportimi Financiar</th> </tr> <tr> <td>Shpenzimet/Alokimet</td> <td></td> <td>Buxheti i shtetit</td> <td>(Financim I</td> </tr> <tr> <td>Shpenzimet financiare</td> <td></td> <td>0</td> <td>4,962,555</td> </tr> <tr> <td>Alokimet e pritura</td> <td></td> <td></td> <td></td> </tr> </table>				Raportimi Financiar				Shpenzimet/Alokimet		Buxheti i shtetit	(Financim I	Shpenzimet financiare		0	4,962,555	Alokimet e pritura		
Raportimi Financiar																			
Shpenzimet/Alokimet		Buxheti i shtetit	(Financim I																
Shpenzimet financiare		0	4,962,555																
Alokimet e pritura																			
Rekomandime:																			

Institucioni Raportues			Ministria e Arsimit dhe Sportit					
Periudha e Raportimit			JANAR-QERSHOR 2025					
Numri i Masave për tu raportuar		1						
Qëllimi i politikës C: Arsimit i lartë gjithëpërfshirës që përmbush standardet ndërkombëtare të cilësisë, integritetit akademik e transparencës dhe është promotor i zhvillimit ekonomik dhe shoqëror të vendit.								
II	Objektivi specifik C2 Nxitja e përsosmërisë në mësimdhënie dhe kërkim.							
Nr.1	Masat	Afati Kohor	Rezultatet e pritshme	Indikatorët	Niveli i zbatimit			
	C.2.1 Përmirësimi i kapacitetit të personelit akademik në mësimdhënie dhe kërkim shkencor.	TM2 2022-TM4–2026	C.2.1.1 Nxitja e krijimit të qendrave në universitete për trajnimin në mësimdhënie dhe kërkim.	C.2.1.1 Numri i qendrave për trajnimin në mësimdhënie dhe kërkim.	E zbatuar	E pazbatuar	Pjesërisht	Në proces
		TM2 2022-TM3 2026	C.2.1.2 Zbatimi i incentivave për rezultate në punën shkencore.	C.2.1.2 Politikat mbështetese të UV për punën shkencore.				
		TM2 2022-TM4 2025	C.2.1.3 Masa nxitëse për bashkëpunime institucionale midis akademikëve të diasporës dhe institucioneve të arsimit të lartë.	C.2.1.3 Numri i leksioneve dhe kurseve të mbajtura nga pedagoget e diasporës.				
Raportimi mbi zbatimin e masës :								
C.2.1.1 Nxitja e krijimit të qendrave në universitete për trainimin në mësimdhënie dhe kërkim.								

SMART Universitet

Për të përmbushur qëllimin dhe objektivat e ndërkombëtarizimit UV, ka krijuar një sërë iniciativash, përfshirë laboratorët mbështetëse. Një nga këto nisma është Qendra Smart City Hub e integruar në strukturën e Departamentit të Biznesit, e cila është e mbështetur nga projekti SMART.

Projekti SMART trajton problemin e kapacitetit të ulët të inovacionit në fushën e specializimit inteligjent në Ballkanin Perëndimor, konkretisht në Shqipëri, Bosnje-Hercegovinë dhe Mal të Zi. Projekti është krijuar për të mbështetur sistematikisht universitetet partnere për të kapërcyer rolin e tyre si ofrues njohurish dhe për t'u bërë projektues aktivë të ekosistemit rajonal të inovacionit, ku palë të ndryshme të interesuara takohen sipas Modelit të Inovacionit "Quintuple Helix": universitetet si ofrues njohurish, kompani, qeveri dhe organizata publike, shoqëria civile dhe organizatat mjedisore. Projekti synon të zbusë hendekun ekzistues midis rezultateve të AL dhe kërkesave të tregut të punës.

Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë është shpallur fitues në thirrjet kombëtare të Agjencisë Kombëtare të Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit (AKKSHI) për vitin 2025, duke shënuar një tjetër sukses në fushën e kërkimit shkencor. Në Programin e Projekteve Kombëtare të Kërkimit dhe Zhvillimit (PKKZH) janë shpallur fituese tre projekte: "TRA-DI-T." mbi transformimin dixhital në turizëm, i drejtuar nga Dr. Rezarta Kasëmi (Hasanaj), "Onomastika e Lumit të Vlorës – Trashëgimi arkeologjike-gjuhësor", i drejtuar nga Prof. As. Zamira Alimemaj, dhe "Aspekte juridike dhe gjuhësore për të drejtat e emigrantëve", i drejtuar nga Prof. As. Kozeta Hyso. Në Programin e Infrastrukturës së Kërkimit Shkencor (PIKSH), është shpallur fitues projekti "Ngritja e Qendrës Shkencore për Monitorimin dhe Ekologjinë Detare në Vlorë", i drejtuar nga PhD Ina Nasto. Ky rezultat konfirmon përkushtimin e Universitetit të Vlorës në zhvillimin e kapaciteteve kërkimore dhe në promovimin e shkencës dhe inovacionit.

Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë mbështet zhvillimin e kërkimit shkencor me fonde të buxhetit të vet, duke financuar 23 projekte kërkim-zhvillimi për periudhën maj-nëntor 2025, me një fond total prej 13,199,600 lekësh. Projektet janë përzgjedhur në mënyrë konkurruese dhe përfshijnë fusha të ndryshme si ekonomia, biznesi, turizmi, teknologjia, intelijenca artificiale, mjedisi, biologjia, shkencat detare, edukimi, shëndetësia dhe albanologjia. Ato synojnë forcimin e lidhjes mes mësimdhënies dhe kërkimit, nxitjen e bashkëpunimit ndërdisiplinor dhe ndikimin konkret në komunitet. Në projekte janë përfshirë pedagogë, studiues dhe studentë nga të gjitha njësitë akademike, me qëllim zhvillimin profesional, përmirësimin e ofertës akademike dhe afrimin e universitetit me nevojat e tregut dhe të shoqërisë.

Qendra e Studimeve Ndërdisiplinore për Zhvillim Rajonal (RDC)

Qendra e Studimeve Ndërdisiplinore për Zhvillim Rajonal (RDC) e përfshirë në strukturën organizative të UV, mbështet aktivitetet të misionit të tretë të IAL-ve, me një larmi iniciativash dhe veprimtarish të fokusuara në realizimin e misionit të saj për zhvillim rajonal.

Gjatë periudhës njëvjeçare janar-dhjetor 2024, Qendra ka qenë dukshëm mjaft aktive dhe produktive duke mundësuar realizimin e pjesës më të madhe të aktiviteteve sipas kornizës kohore të planifikuar.

Konkretisht, RDC ka siguruar shërbime trajnimit në kurset e trajnimit për mësues në zonën e qarkut të Vlorës. Gjithashtu ka zhvilluar dhe ka fituar duke akredituar 4 module te reja trajnimit pas aplikimit të dërguar tek ASCAP vitin e kaluar në fazën e parë, dhe ka kaluar me sukses fazën e dytë të aplikimeve. Tashmë qendra RDC ka siguruar 20 module trajnimit 1 dhe 2 kreditëshe duke u përqëndruar kryesisht mbi grupin e mësuesve dhe lektoreve, tek studentët e Universitetit të Vlorës në programet e mësuesisë dhe punonjës të tjerë arsimore.

Gjithashtu janë zhvilluar veprimtari shkencore kërkimore duke marrë pjesë aktivisht në thirrje për aplikime me projekte europiane në programe erasmus plus dhe interreg.

Gjithashtu një pjesë e veprimtarisë së qendrës është fokusuar në koordinimin dhe bashkë koordinimin e projekteve në zbatim si workshop, vizita trajnuese, konferenca, sesione trajnimit të tjera janë të fokusuar në tema specifike për të ndihmuar studentët në orientimin drejt tregut të punës si dhe në konceptet që ata kanë nevojë të dinë më tepër si dhe zhvillimin e strategjive të studimeve për t'u përgatitur në mënyrë efektive për jetën si profesionist. Qendra RDC ka dhënë kontribut të rëndësishëm dhe mbështetje për institucionin duke e përfaqësuar atë në rrjete europiane si dhe duke aplikuar në rrjete të reja Programi i Formimit të Vazhduar në fushën Psiko Pedagogjike prej vitit akademik 2023-2024 me Urdhër MAS nr.373 dt 14.07.2023.

Shkolla e Drejtorëve . UV ka aplikuar për t'u bërë partner me Shkollën e Drejtorëve. Ky është viti i dytë për UV, pas diplomimit të brezit të parë, i cili shënoi një performancë shumë të mirë. Aktualisht, ka filluar edhe brezi i dytë. UV ofron një staf akademik prej 9 pedagogësh, të cilët ofrojnë nga një modul secili, si dhe 6 staf për trajnimet.

C.2.1.2 Zbatimi i incentivave për rezultate në punën shkencore.

Përmirësimi i kapacitetit të personelit akademik në mësimdhënie dhe kërkim shkencor është një proces kyç në aktivitetin e UV. Një nga mënyrat më efektive për të arritur këtë qëllim është përmes zbatimit të incentivave që ndihmojnë në motivimin e personelit akademik për të arritur rezultate më të mira në kërkimin shkencor dhe mësimdhënie. Në këtë kontekst, UV ka miratuar me Vendim Senati Akademik Nr. 16, datë 06.05.2021 "Për miratimin e procedurës së aplikimit, miratimit, implementimit dhe pagesës së mini-projekteve të financuara nga buxheti i UV-së." si dhe Vendim Senati Akademik Nr.17, datë 06.05.2021 "Për miratimin e procedurës së aplikimit, miratimit, implementimit dhe pagesës e projekteve të financuara nga programet e BE-së."

Aplikimi i këtyre dy vendimeve ka rritur ndjeshëm numrin e aplikimeve të projekteve me financim të brendshëm/jashtëm. UV-ja është shpallur fituese e 4 (katër) projekteve nga thirrjet e AKKSH-it konkretisht 1 (një) projekt për përmirësimin e infrastrukturës "Ngritja e qendrës kërkimore shkencore për monitorimin dhe ekologjinë" dhe 3 (tre) të tjerë që synojnë rritjen e bashkëpunimit në mbështetje të hulumtimeve me ndikim të drejtpërdrejtë në komunitet duke zhvilluar burime të reja shkencore dhe trajnimit i ekepeve të reja studimore.

Zbatimi i incentivave për rezultate të mira në kërkimin shkencor është një mjet i fuqishëm për të rritur motivimin e personelit akademik dhe për të përmirësuar cilësinë e arsimit dhe kërkimit shkencor. Universiteti "Ismail Qemali" i Vlorës, duke ndjekur ndikimin dhe strategjinë e ndërtues, ofron mundësi në zhvillimin dhe promovimin e stafit akademik nëpërmjet aplikimeve në projekte ndërkombëtare dhe financime nga Bashkimi Europian. Ky proces i përbërë

viores, duke ndjekur adrehtimet dhe strategjitë përkatëse, ofron mundësi për zhvillimin dhe avancimin e stait akademik nëpërmjet aplikimeve për projekte ndërkombëtare dhe financimeve nga Bashkimi Europian. Ky proces jo vetëm që mbështet zhvillimin e kërkimit shkencor, por gjithashtu kontribuon në rritjen e cilësisë së arsimit dhe përgatitjen e specialistëve të kualifikuar për të përballuar sfidat e sotme dhe të ardhshme.

Universiteti “Ismail Qemali” Vlorë ofron program studimi të ciklit të tretë, Doktoraturë në

“Studime gjuhësore, letrare dhe kulturore”, të organizuar nga grupimi i njëjësive: Departamenti i

Gjuhëve të Huaja në bashkëpunim me Departamentin e Gjuhës Shqipe dhe Letërsisë, pranë

Fakultetit të Shkencave Humane. Universiteti “Ismail Qemali” Vlorë mbështet fuqimisht zhvillimin kërkimor dhe shkencor të personelit akademik dhe studentëve, duke inkurajuar rritjen e botimeve në revista ndërkombëtare me impakt të lartë dhe indeksim. Promovon shkrimin e monografive dhe librave të bashkëpunimit akademik dhe organizon konferenca ndërkombëtare dhe workshop-e në bashkëpunim me universitete prestigjioze europiane. Universiteti ofron mbështetje financiare dhe incentive për botime, pjesëmarrje në konferenca, si dhe rimbursim për fitimin e titujve akademikë.

C.2.1.3 Masa nxitëse për bashkëpunime institucionale midis akademikëve të diasporës dhe institucioneve të arsimit të lartë.

Programi i Bashkëpunimit Akademik me Diasporën Shqiptare

UV-ja ka intensifikuar bashkëpunimin me akademikët e diasporës, duke forcuar rrjetëzimin dhe shkëmbimin e njohurive.

Si rezultat i bashkëpunimit midis UV-së dhe AADF konkretisht programit READ DIASPORA janë shpallur 3 (tre) projekt fituese si dhe gjatë kësaj periudhe janë nënshkruar disa marrëveshje bashkëpunimi me institucione dhe organizata të ndryshme kombëtare dhe ndërkombëtare.

Leksione të hapura mbajtur në datën 21.03.2025 të organizuara nga Departamenti i Finances dhe Kontabilitetit me lektore Dr. Adelajda Matuka, Kërkuese Shkencore në Universitetin e Bolonjës, Itali, në bashkëpunim me Filloreta Madani, Profesoreshë e Asociuar në Departamentin e Financës dhe Kontabilitetit në Universitetin e Vlorës "Ismail Qemali", ofruan kursin "Programimi në R Studio". Ky kurs është krijuar për të pajisur studentët me aftësi thelbësore në përdorimin e R Studio për analiza të dhënash, vizualizim dhe modelim ekonometrik. Ai mbulon koncepte bazë si manipulimi i të dhënave, analiza statistikore, modelet e regresionit dhe teknika të ndryshme të analizës së të dhënave.

Në datat 19–23 maj 2025 janë zhvilluar Minikurse "Mini Course on Data Sciences and AI" të organizuara nga Prof. Artur Elezi –dhe Prof. Michael Robinson profesorë në Universitetin Amerikan në Washington DC, SHBA, në kuadër të bashkëpunimeve akademike dhe shkëmbimeve ndërkombëtare në fushën e shkencave kompjuterike dhe inteligjencës artificiale.

Arsyet e mozbatimit (në rast kur masa nuk është zbatuar)

Raportimi Financiar

Shpenzimet/Alokimet		Buxheti i shtetit	Donatori/ët	Burime të tjera(Të ardhurat e veta të UV-së)
Shpenzimet financiare				2,190,696
Alokimet e pritura				

Rekomandime:

Institucioni Raportues			Ministria e Arsimit dhe Sportit					
Periudha e Raportimit			JANAR-QERSHOR 2025					
Numri i Masave për tu raportuar		3						
Qëllimi i politikës C: Arsim i lartë gjithëpërfshirës që përmbush standardet ndërkombëtare të cilësisë, integritetit akademik e transparencës dhe është promotor i zhvillimit ekonomik dhe shoqëror të vendit.								
III	Objektivi specifik C3 Ndërlidhja më e mirë e arsimit të lartë me tregun e punës.							
Nr.1	Masat	Afati Kohor	Rezultatet e pritshme	Indikatorët	Niveli i zbatimit			
	C.3.1 Harmonizimi i programeve në IAL me kërkesat e tregut të punës	TM1 2022-TM3 2026 TM1 2022-TM4 2026 TM2 2022-TM2 2023 TM2 2022-TM4 2026 TM3 2022-TM4 2026 TM3 2021-TM4 2026	C.3.1.1 Pasurimi i ofertës së programeve profesionale. (E zbatuar) C.3.1.2 Paketa e programit të inovacionit dhe ekselencës në manifakturë dhe IT-së. (E zbatuar) C.3.1.3 Krijimi i një regjistri qendror të studentëve të diplomuar në IAL-të shqiptare.(E zbatuar) C.3.1.4 Analiza e vazhdueshme e ecurisë së studentëve të diplomuar sipas sektorëve, do të krijojë mundësinë e orientimit të kuotave sipas degëve përkatëse, në raport me kërkesat.(Pjesërisht) C.3.1.5 Ofrimi i programeve të formimit të vazhdueshëm.(E zbatuar) C.3.1.6 Krijimi i projekteve të përbashkëta të bashkëpunimit midis shoqatave të biznesit dhe universiteteve. (E zbatuar)	Numri i Diplomave Profesionale; Regjistri i studentëve; Databaza Alumni; Numri i projekteve/marrëveshjeve të bashkëpunimit me bizneset	E zbatuar	E pazbatuar	Pjesërisht	Në proces
Raportimi mbi zbatimin e masës :								
C.3.1.1 Universiteti "Ismael Qemali" vlorë gjatë vitit akademik 2024-2025 periudha Janar-Qershor 2025 ka aplikuar për 16(gjashtëmbëdhjetë) programe në të gjitha ciklet e studimit përkatësisht : 8(tetë) programe me karakter profesional nga të cilat janë miratuar nga MAS 2(dy) programe studimi. 1. Programim Web dhe dizajnim Digjital -FSHTN, me fushë në Inxhinieri, prodhim dhe ndërtim . 2. Asistencë në Geriatri-FSH me fushë shkenca mjekësore Kanë kaluar fazën e dytë 2 programe: 1. Specialist në shërbime dhe operacione detare e bregdetare. 2. Operator Turistik . C.3.1.2 Këtë vit akademik, periudha Janar-Qershor 2025 janë miratuar 2 programe të fushës IT-së: 1. DP ne 'Web dhe dizajnim Digjital' 2 . BSc në gjuhën angleze 'Computer Engineering' C.3.1.3 Sektori i Kurrikulave dhe statistive ka krijuar dabase e studentëve të diplomuar dhe përditëson këtë regjistër çdo vit. C.3.1.4 Analiza është zhvilluar në bashkëpunim me strukturat akademike dhe Sektorin i këshillimit të karrierës të shërbimit ndaj studentëve dhe alumnit dhe përmes mbledhjes dhe përpunimit të të dhënave mbi vendosjen në punë të të diplomuarve. Janë marrë në konsideratë tregues si: sektori i punësimit, koha e punësimit pas diplomimit dhe								

1

përputhshmëria ndërmjet fushës së studimit dhe profilit të punës. Të dhënat e grumbulluara kanë shërbyer si bazë për të identifikuar tendencat kryesore dhe për të orientuar kuotat e pranimit drejt degëve me kërkesë të lartë në tregun e punës.

C.3.1.5 Programi i Formimit të Vazhduar në fushën Psiko-Pedagogjike prej vitit akademik 2023-2024 me Urdhër MAS nr.373 dt 14.07.2923. Shkolla e Drejtorëve UV ka aplikuar për t'u bërë partner me Shkollën e Drejtorëve. Ky është viti i dytë për UV, pas diplomimit të brezit të parë, i cili shënoi një performancë shumë të mirë. Aktualisht, ka filluar edhe brezi i dytë. UV ofron një staf akademik prej 9 pedagogësh, të cilët ofrojnë nga një modul secili, si dhe 6 staf për trajnimet. Kurset MOOC Moodle dhe Linux

Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë ka krijuar një eksperiencë të konsoliduar në përdorimin e platformave dixhitale dhe zhvillimin profesional të mësuesve përmes Qendrës së Zhvillimit Rajonal, duke modernizuar trajnimet me teknologji të avancuara dhe ofruar qasje fleksibël në përmbajtje edukative online përmes platformës Moodle dhe kurseve MOOC. Universiteti po zhvillon sistemin e mikro-kredencialeve për njohjen formale të kompetencave specifike, si dhe integron SmartLab-et me teknologji inovative për të rritur aftësitë praktike të mësuesve në përdorimin e TIK-ut dhe mësimin bashkëkohor. Në kuadër të zhvillimit profesional, Universiteti ofron edhe kurse praktike si Kursi Veror "Komandat e LINUX dhe Hyrje në Bash Scripting" gjatë, që zhvillohet në Universitetin "Ismail Qemali" Vlorë, duke ofruar certifikatë pjesëmarrjeje dhe mundësi për përvetësimin e njohurive të avancuara teknike.

C.3.1.6 Projektet DUALBA dhe SMART synojnë forcimin e bashkëpunimit ndërmjet universiteteve dhe sektorit të biznesit. DUALBA fokusohet në zbatimin e arsimit dual, duke lidhur mësimin teorik me përvojën praktike në ndërmarrje dhe duke rritur punësueshmërinë e studentëve përmes bashkëpunimit të qëndrueshëm me sektorin privat. Projekti SMART synon të shndërrojë universitetet në aktorë aktivë të ekosistemit të inovacionit përmes krijimit të Qendrave të Inovacionit dhe Rrjetit të Shkëmbimit të Njohurive SMART, duke lehtësuar ndërveprimin afatgjatë me bizneset dhe promovuar punësimin e studentëve e stafit. Universiteti i Vlorës, përmes projekteve me financim të jashtëm, si Startup 10 në partneritet me CHIEM-Bari, ka punuar për krijimin e një rrjeti ndërmjet kompanive shqiptare dhe italiane, duke zhvilluar trajnime për të promovuar dhe nxitur startup-et në Shqipëri. Po ashtu, projekti 'Sustainable University - Enterprise Cooperation for Improving Graduate Employability' ka për qëllim krijimin e një laboratorit, nënshkrimit e marrëveshjeve të bashkëpunimit me bizneset, ndërtimin e një platforme online dhe aktivizimin e pjesëmarrjes së grupeve të interesit në këtë iniciativë.

Arsyet e mozbatimit (në rast kur masa nuk është zbatuar)

Raportimi Financiar

Shpenzimet/Alokimet		Buxheti i shtetit	Donatori/ët	Burime të tjera
Shpenzimet financiare				
Alokimet e pritura				

Rekomandime:

Nr.2	Masa	Afati Kohor	Rezultatet e pritshme	Indikatorët	Niveli i zbatimit			
	C.3.2 Rritja e mundësive për punë praktike në studimet e larta.	TM3 2022-TM3 2026	C.3.2.1 Krijimi/funksionalizimi i zyrave të karrierës në IAL-të publike.	Detyrat funksionale te Sektorit te Keshillimit te Karrieres te UV	E zbatuar	E pazbatuar	Pjesërisht	Në proces
	Raportimi mbi zbatimin e masës							
	C.3.2.1 Sektori i Këshillimit të Karrierës në Universitetin e Vlorës luan një rol të rëndësishëm në ndërmjetësimin e studentëve për punësim, duke shërbyer si urë lidhëse midis tyre dhe tregut të punës. Nëpërmjet bashkëpunimit me institucione dhe kompani partnere, sektori informon studentët për mundësitë e punësimit dhe praktikës, i ndihmon ata në përgatitjen e dokumentacionit (CV, letër motivimi) dhe organizon aktivitete si panairë karriere, trajnime dhe intervista. Qëllimi është rritja e mundësive të integritit profesional të studentëve pas diplomimit.							
	Arsyet e mozbatimit (në rast kur masa nuk është zbatuar)							
	Raportimi Financiar							
	Shpenzimet/Alokimet		Buxheti i shtetit	Donatori/ët	Burime të tjera			
	Shpenzimet financiare							
	Alokimet e pritura							

Rekomandime:								
Nr. 3	Masa	Afati Kohor	Rezultatet e pritshme	Indikatorët	Niveli i zbatimit			
3	C.3.3 Promovimi i ndërdisiplinaritetit dhe programeve STEM.	TM3 2022-TM3 2026	C.3.3.1 Zhvillimi/reformimi i programeve ndërdisiplinore dhe programeve STEM.	Numri i aktiviteteve trajnuese STEM Numri i projekteve STEM	E zbatuar	E pazbatuar	Pjesërisht	Në proces
	Raportimi mbi zbatimin e masës							
	C.3.3.1 Në periudhën janar-qershor 2025, Qendra e Zhvillimit Rajonal (RDC) në Universitetin e Vlorës ka ndërmarrë një sërë iniciativash të rëndësishme për promovimin e qasjeve ndërdisiplinore dhe zhvillimin e programeve STEM. Ndër aktivitetet kryesore përfshihet organizimi i një workshopi mbi energjitë e rinovueshme, një ditë informuese për lancimin e kurseve pilot në formatin Mikrocredencial dhe të kurseve ndërdisiplinore në platformën Moodle, si dhe një konferencë rinore në kuadër të rrjetit ASECU, ku studentët paraqitën artikuj shkencorë mbi përdorimin e IoT në bujqësi. Aktivitetet kanë përfshirë mbi 50 studentë të fakulteteve teknike dhe natyrore, si dhe 8 pjesëmarrës me 4 punime në një konferencë ndërkombëtare në Korinth, organizuar nga Universiteti AEGEN. Gjithashtu, janë angazhuar 26 mësues dhe pedagogë në ditën informuese mbi mikrocredencialet, si dhe 12 pedagogë në hartimin e propozimeve për projekte në fushën e STEAM dhe energjisë së gjelbër për programin Erasmus+. Ndër arritjet përfshihet zhvillimi i katër kurseve MOOC dhe pjesëmarrja në gjashtë aplikime në Erasmus+ dhe një në IPA ADRIION, duke promovuar qasje ndërdisiplinore me kontribut nga departamente të ndryshme. Pjesë e rezultateve është edhe përfshirja në projektin PRENCO për monitorimin e ndotjes së ujërave, ku u angazhuan ekspertë nga departamenti i kimisë, biologjisë dhe shkencave kompjuterike. Këto nisma kanë ndikuar ndjeshëm në rritjen e ndërgjegjësimit mbi rëndësinë e qasjeve ndërdisiplinore dhe STEM në politikat institucionale, si dhe kanë rritur bashkëpunimin me shkolla, biznese dhe institucione kërkimore.							
	Arsyet e mozbatimit (në rast kur masa nuk është zbatuar)							
	Raportimi Financiar							
Shpenzimet/Alokimet			Buxheti i shtetit	Donatori/ët	Burime të tjera			
Shpenzimet financiare								
Alokimet e pritura								
Rekomandime:								

Institucioni Raportues			Ministria e Arsimit dhe Sportit					
Periudha e Raportimit			JANAR-QERSHOR 2025					
Numri i Masave për tu raportuar		1						
Qëllimi i politikës C: Arsimit i lartë gjithëpërfshirës që përmbush standardet ndërkombëtare të cilësisë, integritetit akademik e transparencës dhe është promotor i zhvillimit ekonomik dhe shoqëror të vendit.								
IV	Objektivi specifik C4 Sigurimi i integritetit akademik, transparencës dhe llogaridhënies në sektorin e arsimit të lartë.							
Nr.1	Masat	Afati Kohor	Rezultatet e pritshme	Indikatorët	Niveli i zbatimit			
1	C.4.1 Sigurimi i transparencës dhe zbatimi i praktikave të mira të integritetit akademik në IAL.	TM2 2022-TM3 2022 TM2 2022-TM2 2023 TM3 2021-TM4 2022 TM2 2022-TM2 2023	C.4.1.1 Zhvillimi i rregulloreve për publikimin e të dhënave dhe dokumenteve përkatëse në faqen e internetit të IAL-ve (Open Data). C.4.1.2 Miratimi i kodeve etike institucionale në të gjitha IAL-të. C.4.1.3 Instalimi i softuerit antiplagjiaturë në IAL-të publike. C.4.1.4 Ndërtimi i kapacitetit të organeve kolegjiale të IAL-ve publike për të siguruar respektimin e parimeve të integritetit akademik, transparencës dhe llogaridhënies.	Rregulloret e miratuara Softwar antiplagjiature	E zbatuar	E pazbatuar	Pjesërisht	Në proces
	Raportimi mbi zbatimin e masës :							
	C.4.1.1 Për të siguruar transparencën dhe për të zbatuar praktika të mira të integritetit akademik, Universiteti "Ismail Qemali" i Vlorës ka zhvilluar dhe implementuar një sërë rregulloresh dhe procedurash që garantojnë publikimin dhe aksesin e të dhënave dhe dokumenteve përkatëse. Ky proces është i orientuar drejt rritjes së besueshmërisë dhe sigurisë, duke u mundësuar të gjithëve, përfshirë studentët, pedagogët dhe publikun, të kenë akses në informacionin e rëndësishëm për funksionimin dhe aktivitetet e universitetit. Disa nga rregulloret dhe dokumentet të cilat janë të aksesueshme online janë: Rregullorja e Universitetit të Vlorës https://univlora.edu.al/rregullorja/ Doktoratat https://univlora.edu.al/doktoratat/ Kodi i Etikës https://univlora.edu.al/kodi-i-etikes/ Rregullorja për Parandalimin e Konfliktit të Interesave në Ushtrimin e Funksioneve Publike në Universitetin "Ismail Qemali" Vlorë https://univlora.edu.al/rregullore-per-prandalimin-e-konfliktit-te-interesave-ne-ushtrimin-e-funksioneve-publike-ne-universitetin-ismail-qemali-vlore/ Rregullorja për Organizimin e Zgjedhjeve për Autoritetet dhe Organet Drejtuese në Universitetin "Ismail Qemali" Vlorë https://univlora.edu.al/rregullore-per-organizimin-e-zgjedhjeve-per-autoritetet-dhe-organet-drejtuese-ne-universitetin-ismail-qemali-vlore/ Rregullorja për Mbrojtjen, Përpunimin, Ruajtjen dhe Sigurinë e të Dhënave Personale https://univlora.edu.al/rregullore-per-mbrojtjen-perpunimin-ruajtjen-dhe-sigurine-e-te-dhenave-personale/ Vendimi Nr. 94, datë 12.12.2024 https://univlora.edu.al/wp-content/uploads/2025/01/Vendimi-Nr.94-dt-12.12.2024_opt.pdf Këto rregullore dhe dokumente janë të qasshme për publikun dhe i ofrojnë një mundësi për të gjitha palët e interesuara që të ndjekin dhe të verifikojnë aktivitetet dhe procedurat e universitetit, duke promovuar kështu integritetin dhe transparencën në çdo nivel të funksionimit të tij. C.4.1.2 Vendim Senati Nr.100, datë 28.12.2020 "Për rregulloren e Këshillit të Etikës" C.4.1.3 UV ka blere softwarin antiplagjiaturë Turnitin per periudhen shtator 2025-2026. C.4.1.4 Vendimet e SA,BA,Rektoratit, Dekanatëve dhe Departamentëve zhvillohen me mbajtje procesverbalesh, të cilat më pas zbardhen, dërgohen në formë elektronike dhe firmosen nga anëtarët prezent në mbledhje. Të gjithë sektorët jo-akademik, departamentet, fakultetet si dhe SA dhe BA dorëzojnë periodikisht raporte vjetore sipas formatit të përcaktuar nga MASR. Këto raporte publikohen në web dhe diskutohen në mbledhjet e fundvitit. Procedurat e ngritjes së organeve të zgjedhura: KIZ studentor (Dhjetor 2024), bëhen transparente në faqen e mediave sociale dhe web dhe votohen në organet kolegjiale. Të gjitha rregulloret e programeve mësimore, të doktoratave, publikimeve në media sociale, cdo syllabus gjithashtu kanë nene për integritetin akademik dhe dënimin e plagjiaturës.							
Arsyet e mozbatimit (në rast kur masa nuk është zbatuar)								

Raportimi Financiar				
Shpenzimet/Alokimet		Buxheti i shtetit	Donatori/ët	Burime të tjera UV
Shpenzimet financiare				600,000 L
Alokimet e pritura				
Rekomandime:				

Institucioni Raportues			Ministria e Arsimit dhe Sportit					
Periodha e Raportimit			JANAR-QERSHOR 2025					
Numri i Masave për tu raportuar		2						
Qëllimi i politikës C: Arsim i lartë gjithëpërfshirës që përmbush standardet ndërkombëtare të cilësisë, integritetit akademik e transparencës dhe është promotor i zhvillimit ekonomik dhe shoqëror të vendit.								
IV	Objekti i specifik C5 Përmirësimi i statusit socio-ekonomik të studentëve përmes ofrimit të shërbimeve cilësore dhe formave të ndryshme të ndihmës financiare.							
Nr.1	Masat	Afati Kohor	Rezultatet e pritshme	Indikatorët	Niveli i zbatimit			
	C.5.1 Pasurimi dhe përmirësimi i shërbimeve për studentët.	TM3 2021-TM4–2026 TM3 2022-TM4 2026 TM3 2021-TM4 2026	C.5.1.1 Dhënia e bursave për studentët ekselente dhe studentët në nevojë. C.5.1.2 Ndërmjetësim për punësimin e studentëve. C.5.1.3 Zgjerimi i listës së shërbimeve të favorizuara për studentët mbi bazën e kartës së studentit. (Bashkia Vlore)	Numri i bursave per studentet Detyrat funksionale te Sektorit te Sherbimeve per studentet	E zbatuar	E pazbatuar	Pjesërisht	Në proces
Raportimi mbi zbatimin e masës :								
C.5.1.1 Dhënia e bursave për studentët ekselent dhe ata që kanë nevoja financiare është një proces i rregullt, që realizohet çdo vit nga Komisioni i Bursave dhe Bordi i Administrimit. Në periudhën Janar -Dhjetor 2025 , është miratuar Vendimi sipas vendimeve të Bordit të Administrimit, nr.72, datë 23.12.2024, nr.21, datë 28.02.2025 dhe nr.31, datë 11.04.2025, për vitin akademik 2024-2025. Marreveshje(nr.Prot 1117/14 date 14.05.2025) bashkëpunimi ndermjet UV dhe Marina Residences Vlore SHPK, e cila ka per qellim dhenien e bursave per studentet e UV. Marreveshje(nr.Prot 1408 date 14.05.2025) bashkëpunimi ndermjet UV dhe Fondacioni Alsar , e cila ka per qellim dhenien e bursave per studentet e UV. C.5.1.2 Sektori i Këshillimit të Karrierës në Universitetin e Vlorës luan një rol të rëndësishëm në ndërmjetësimin e studentëve për punësim, duke shërbyer si urë lidhëse midis tyre dhe tregut të punës. Nëpërmjet bashkëpunimit me institucione dhe kompani partnere, sektori informon studentët për mundësitë e punësimit dhe praktikës, i ndihmon ata në përgatitjen e dokumentacionit (CV, letër motivimi) dhe organizon aktivitete si panaire karriere, trajnime dhe intervista. Qëllimi është rritja e mundësive të integritit profesional të studentëve pas diplomimit.								
1	1. Identifikimi i nevojave dhe profileve të studentëve •Mbledhja e të dhënave mbi studentët (programi i studimit, interesat profesionale, aftësitë, CV-të). •Organizimi i takimeve individuale ose në grupe për këshillim karriere dhe orientim profesional. 2. Krijimi i marrëdhënieve me tregun e punës •Kontaktimi i institucioneve dhe bizneseve vendore/kombëtare për mundësi bashkëpunimi. •Nënshkrimi i marrëveshjeve të bashkëpunimit me kompani që shprehin interes për punësim apo praktika profesionale. 3. Njoftimi i studentëve mbi ofertat e punës •Publikimi i ofertave të punës/praktikës në faqen zyrtare të universitetit ose përmes email-it institucional. •Shpërndarja e informacionit përmes rrjeteve sociale ose platformave të brendshme. 4. Ndërmjetësimi i aplikimeve •Ndihma në përgatitjen e dokumentacionit (CV, letër motivimi, portofol). •Dërgimi i aplikimeve te punëdhënësit në emër të studentëve ose lehtësimi i kontakteve. 5. Organizimi i aktiviteteve të ndërmjetme •Panaire karriere në bashkëpunim me sektorin privat dhe publik. •Trajnime për zhvillimin e aftësive të punësimit (si të përgatitmi për intervista, soft skills, etj). •Takime me ish-studentë të suksesshëm (Alumni) për të ndarë përvoja dhe rrjete profesionale. 6. Ndjekja pas ndërmjetësimit							

- Monitorimi i ecurisë së studentëve të punësuar apo të përfshirë në praktika.
- Kërkimi i feedback-ut nga punëdhënësit mbi përshtatshmërinë e profileve dhe përgatitjes së studentëve.

C.5.1.3 Zgjerimi i listës së shërbimeve të favorizuara për studentët në bazë të kartës së studentit është një kompetencë e cila realizohet nga Bashkia e Vlorës, si pjesë e angazhimeve të saj për përmirësimin e kushteve dhe mbështetjes për studentët.

Arsyet e mozbatimit (në rast kur masa nuk është zbatuar)

Raportimi Financiar

Shpenzimet/Alokimet		Buxheti i shtetit	Donatori/ët	Burime të tjera
Shpenzimet financiare		15,290,000		
Alokimet e pritura				

Rekomandime:

Nr.2	Masa	Afati Kohor	Rezultatet e pritshme	Indikatorët	Niveli i zbatimit			
	C.5.2 Mbështetja e studentëve për përmirësimin e arritjeve akademike.	TM3 2022-TM4 2026	C.5.2.1 Tutorimi/mentorimi i studentëve në të gjitha IAL-të.		E zbatuar	E pazbatuar	Pjesërisht	Në proces
Raportimi mbi zbatimin e masës C.5.2.1 Ky proces realizohet nga këshilltarët akademikë në fakultete, Sektori i Këshillimit të Karrierës dhe zyrat e studentëve, të cilët ofrojnë mbështetje dhe këshillim për studentët. Ata zhvillojnë gjithashtu seminare këshilluese mbi tema të ndryshme, duke ofruar udhëzime dhe informacione të nevojshme për orientimin e studentëve në karrierë dhe zhvillimin e aftësive të tyre profesionale. Laboraret didaktike qendrojnë te hapura ne dispozicion te studenteve jashte orareve mesimore per tu lejuar atyre mundesite e praktikimit edhe pertej kohes se labororit apo seminarit.								
Arsyet e mozbatimit (në rast kur masa nuk është zbatuar)								
Raportimi Financiar								
	Shpenzimet/Alokimet		Buxheti i shtetit	Donatori/ët	Burime të tjera			
	Shpenzimet financiare							
	Alokimet e pritura							

Rekomandime:

Institucioni Raportues			Ministria e Arsimit dhe Sportit					
Periudha e Raportimit			JANAR-QERSHOR 2025					
Numri i Masave për tu raportuar		4						
Qëllimi i politikës C: Arsimit të lartë gjithëpërfshirës që përmbush standardet ndërkombëtare të cilësisë, integritetit akademik e transparencës dhe është promotor i zhvillimit ekonomik dhe shoqëror të vendit.								
I	Objektivi specifik C6: Ndërkombëtarizimi i arsimit të lartë në Shqipëri dhe integrimi në Zonën Evropiane të Arsimit të Lartë (EHEA).							
Nr.1	Masat	Afati Kohor	Rezultatet e pritshme	Indikatorët	Niveli i zbatimit			
1	C.6.1 Nxitja e IAL-ve për të hapur programe studimi të përbashkëta me IAL-të evropiane ose programe në gjuhën angleze.	TM3 2021-TM4 2026	C.6.1.1 Fondi për bashkëfinancimin e projekteve ndërkombëtare të bashkëpunimit akademik, përfshirë programet studimore të përbashkëta të IAL-ve shqiptare me universitetet evropiane.	Numri i programeve të përbashkëta studimore të krijuara.	E zbatuar	E pazbatuar	Pjesërisht	Në proces
	Raportimi mbi zbatimin e masës :							
	C.6.1.1 Në Universitetin "Ismail Qemali" Vlorë gjatë vitit akademik 2024-2025, për periudhën janar-qershor 2025 janë miratuar : - 1 (një) program Bachelor në gjuhën angleze "Computer Engineering" 2(dy) riorganizimi të ciklit të parë: Bachelor në Infermieri të Përgjithshme (shqip-anglisht) dhe Bachelor në Infermieri mami (shqip-anglisht) proces 4 (katër) programe: Shkenca Arkitekturore për Trashëgiminë -program i përbashkët (në gjuhën angleze) Bachelor në Inxhinieri Elektrike -program i dyfishtë (riorganizim) Shkencave në Inxhinieri armatimi me profil minor naval dhe navigazion. (program i përbashkët) Shkencave në Mësimdhënie në Gjuhë e Huaj, Gjuha Angleze" (riorganizim në gjuhën angleze)							
	Janë në 1. 2. 3. Master i 4. Master i							
	Arsyet e mozbatimit (në rast kur masa nuk është zbatuar)							
	Raportimi Financiar							
Shpenzimet/Alokimet			Buxheti i shtetit	Donatori/ët(Financim i huaj)	Burime të tjera(Të ardhurat e veta)			
Shpenzimet financiare				1,701,088	105,794			
Alokimet e pritura								
Rekomandime:								
Nr.2	Masa	Afati Kohor	Rezultatet e pritshme	Indikatorët	Niveli i zbatimit			

2	C.6.2 Nxitja e IAL-ve për pjesëmarrje në projekte ndërkombëtare të bashkëpunimit akademik.	TM2 2023-TM4 2026	C.6.1.2 Ngritja e zyrave të projekteve në IAL të publike.	Numri i zyrave të projekteve të krijuara. Numri i stafit të punësuar në zyrën e projekteve. Numri i projekteve të përgatitura dhe të dorëzuara për financim. Numri i projekteve të fituara dhe të zbatuara me sukses	E zbatuar	E pazbatuar	Pjesërisht	Në proces
	Raportimi mbi zbatimin e masës							
	C.6.1.2 Në mbështetje të Vendimit të Senatit Akademik nr. 97 datë 17.12.2024 "Për miratimin e strukturës numerike të përgjithshme dhe organigramës së Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë, si dhe bazuar në Vendimin e Rektoratit nr. 1 datë 20.01.2025 për miratimin e detyrave funksionale të stafit ndihmës-akademik dhe administrativ në nivel institucioni dhe njësie kryesore, është forcuar roli i Sektorit të Kërkimit Shkencor dhe Projekteve. Ky sektor ka rritur angazhimin dhe mbështetjen ndaj personelit akademik në përputhje me strategjinë e kërkimit shkencor dhe ndërkombëtarizimit. Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë i cili po implementon projekte të rëndësishme që lidhen me Zonën Evropiane të Arsimit të Lartë (EHEA) dhe ndërkombëtarizimin e arsimit të lartë, si HEROES, EDUFAIR, SuProM, DUALBA, ILOFORDIGITAL dhe ADRIAMOVE, të cilat kontribuojnë në përmirësimin e cilësisë, inovacionin, bashkëpunimin dhe harmonizimin me standardet e EHEA-së. Universiteti ka kryer gjithashtu 37 aplikime në programe financimi evropian si Erasmus+, Horizon Europe dhe Jean Monnet për vitin 2025, duke synuar ngritjen e kapaciteteve institucionale, krijimin e kurikulave inovative dhe mikrokredencialeve, promovimin e qëndrueshmërisë, ndërkombëtarizimin, dhe zhvillimin e kompetencave sipërmarrëse dhe të qëndrueshmërisë. Projektet e ndryshme trajtojnë gjithashtu edukimin jeshil, përfshirjen sociale, transformimin digjital dhe inovacionin, duke e bërë Universitetin një aktor kryesor në arenën akademike ndërkombëtare. Për të mbështetur këtë angazhim, Sektori i Kërkimit Shkencor dhe Projekteve luan një rol kyç në organizimin dhe koordinimin e aktiviteteve të projektit, duke përfshirë shpërndarjen sistematike dhe transparente të informacionit mbi thirrjet financuese, ofrimin e mbështetjes teknike dhe këshilluese për staf akademik gjatë aplikimit dhe zbatimit të projekteve, si dhe publikimin dhe evidentimin e mundësive për bashkëpunim në kanalet zyrtare të universitetit dhe platformat digjitale. Gjithashtu, krijon dhe mirëmban databaza të përditësuara me informacion mbi thirrjet financuese, partnerët potencialë dhe projektet ekzistuese, duke lehtësuar kështu aksesin dhe koordinimin institucional. Në këtë mënyrë, sektori mbështet realizimin e objektivave strategjike të ndërkombëtarizimit dhe zhvillimit institucional, duke kontribuar në harmonizimin me standardet e Zonës Evropiane të Arsimit të Lartë dhe forcimin e pozicionit të Universitetit në arenën ndërkombëtare akademike dhe atë të kërkimit shkencor.							
	Arsyet e mozbatimit (në rast kur masa nuk është zbatuar)							
Raportimi Financiar								
Shpenzimet/Alokimet			Buxheti i shtetit	Donatori/ët	Burime të tjera			
Shpenzimet financiare								
Alokimet e pritura								
Rekomandime:								
Nr. 3	Masa		Rezultatet e pritshme	Indikatorët	Niveli i zbatimit			
	C.6.3 Ofrimi i programeve studimore ndërkombëtare në Shqipëri.	TM3 2021-TM4 2026	C.6.3.1 Mbështetja e hapjes së degëve/programeve të universiteteve prestigjioze në Shqipëri.	Numri i programeve nderkombetare	E zbatuar	E pazbatuar	Pjesërisht	Në proces
Raportimi mbi zbatimin e masës								
C.6.3.1 Në Universitetin "Ismail Qemali" Vlorë funksionojne keto programe te dyfishta dhe te perbashketa nderkombetare: 1 - BSc in Applied Linguistics in the Field of Tourism (with University of Salento, Italy)								

3	2 - BSc in Mechanical Engineering (with Polytechnic University of Bari, Italy)
	3 - BSc in Electrical Engineering (with Polytechnic University of Bari, Italy)
	4 - BSc in Marine Engineering (with Polytechnic University of Bari, Italy)
	5 - MSc in Design and Management of Tourism and Cultural Systems (with 'Aldo Moro' University, Italy)
	6 - BSc in Architectural Science for Heritage (with Polytechnic University of Bari)
	7 - Msc in Marine Environment Management and Protection (with University of Durrës and University of Montenegro)

Arsyet e mozbatimit (në rast kur masa nuk është zbatuar)

Raportimi Financiar

Shpenzimet/Alokimet		Buxheti i shtetit	Donatori/ët	Burime të tjera			
Shpenzimet financiare							
Alokimet e pritura							

Rekomandime:

Nr.4	Masa		Rezultatet e pritshme	Indikatorët	Niveli i zbatimit			
	C.6.4 Shtimi i mobilitetit të studentëve dhe personelit akademik.	TM3 2021-TM4 2026 TM3 2021-TM4 2026	C.6.4.1 Dhënia e bursave për mobilitetin e stafit akademik dhe studentëve në bazë të meritokracisë. C.6.4.2 Krijimi i parakushteve për njohjen e krediteve të mobilitetit përmes përcaktimit të procedurave të qarta.	Rregullorja për implementimin e marrëveshjeve ndërinstitucionale në kuadër të programit "Erasmus + KA1 ICM"	E zbatuar	E pazbatuar	Pjesërisht	Në proces

Raportimi mbi zbatimin e masës

C.6.4.1 Në mbështetje të nenit 38, pika 1, shkronja d, të ligjit nr. 80 / 2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", nenit 19, pika 1, gërma dh, të Statutit të Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë, si dhe referuar propozimit të Sektorit të Marrëdhënieve me Jashtë me shkresë nr. 1457 prot, datë 20.05.2025, Senati Akademik në mbledhjen e datës 21.05.2025 vendosi të miratojë disa ndryshime në vendimin nr. 19, datë 20.05.2025 "Për miratimin e Rregullores për Implementimin e Marrëveshjeve Ndërinstitucionale në kuadër të programeve Erasmus + KA 107 International Credit Mobility".

Arsyet e mozbatimit (në rast kur masa nuk është zbatuar)

Raportimi Financiar

Shpenzimet/Alokimet		Buxheti i shtetit	Donatori/ët	Burime të tjera			
Shpenzimet financiare							
Alokimet e pritura							

Rekomandime:

Institucioni Raportues			Ministria e Arsimit dhe Sportit					
Periudha e Raportimit			JANAR-QERSHOR 2025					
Numri i Masave për tu raportuar		3						
Qëllimi i politikës C: Arsim i lartë gjithëpërfshirës që përmbush standardet ndërkombëtare të cilësisë, integritetit akademik e transparencës dhe është promotor i zhvillimit ekonomik dhe shoqëror të vendit.								
I	Objekti i politikës C7: Avancimi i infrastrukturës së TIK-ut dhe i shërbimeve digjitale për IAL-të publike.							
Nr.1	Masat	Afati Kohor	Rezultatet e pritshme	Indikatorët	Niveli i zbatimit			
1	C.7.1 Përmirësimi i infrastrukturës së TIK-ut në IAL dhe vizibilitetit në internet.	TM1 2022-TM4 2026	C.7.1.1 Investime në përmirësimin e infrastrukturës së TIK-ut në AL.	Sistemi informativ i UV, Faqja zyrtare e UV, Mediat sociale te UV	E zbatuar	E pazbatuar	Pjesërisht	Në proces
		TM2 2022-TM3 2022	C.7.1.2 Ofrimi i ndihmës IAL-ve për hartimin e politikave për zhvillimin dhe mirëmbajtjen e faqeve të tyre të internetit.					
	Raportimi mbi zbatimin e masës :							
	C.7.1.1 Përmirësim i rrjetit informatik LAN dhe WIFI duke ofruar akses në internet si në laboratore dhe ambiente të tjera të UV, për studentët, personelin akademik dhe personelin ndihmës akademik. Universiteti i Vlorës ka investuar në krijimin dhe përmirësimin e platformave të tij online, duke u bërë më të aksesueshëm dhe transparent për studentët, stafin akademik dhe publikun e gjerë. Nje fond i posatshe ne Buxhetin e vitit 2025 eshte akorduar per transmetimin e reklamave te sponsorizuara per UV ne mediat sociale. Për të përmirësuar ndërveprimin me audiencën dhe për të mundësuar një prezencë më të madhe në hapësirat dixhitale, universiteti është aktiv në platformat sociale të njohura si Facebook, Instagram, YouTube dhe TikTok. www.univlora.edu.al , rrjetet Sociale (facebook, Instagram, Youtube) https://youtube.com/@universitetiismailqemalivlore?si=0Jq_3s1M7cmMI9D6 https://www.instagram.com/uni.ismail_qemali.vlore/profilecard/?igsh=dWpjc5zc3ZrdXAz https://www.facebook.com/profile.php?id=100080334315032 https://www.tiktok.com/@uniismailqemalivlore?_t=8rWLfdBnDOi&_r=1 C.7.1.2 Universiteti 'Ismail Qemali' ka nje ekip specialistesh IT, programues dhe eksperte digitalizimi mese te kualifikuar per te zhvilluar dhe mirembajtur sistemin e brendshem informativ UNVIMAS, web te universitetit, G-suite dhe mediat sociale te UV.							
	Arsyet e mozbatimit (në rast kur masa nuk është zbatuar)							
	Raportimi Financiar							
	Shpenzimet/Alokimet			Buxheti i shtetit	Donatori/ët	Burime të tjera (UV)		
	Shpenzimet financiare					200,000 L		
	Alokimet e pritura							
Rekomandime:								
Nr.2	Masa	Afati Kohor	Rezultatet e pritshme	Indikatorët	Niveli i zbatimit			

	C.7.2 Nxitja e IAL-ve për të organizuar mësimin në distancë dhe “të nxëniet e kombinuar”.	TM1 2023-TM4 2026 TM1 2023-TM4–2026	C.7.2.1 Sigurimi i aksesit në ndonjë nga platformat LMS për IAL-të publike. C.7.2.2 Trajnim i stafit akademik për shfrytëzimin e platformave LMS.	Manuali i përdorimit të sistemit UNVIMAS	E zbatuar	E pazbatuar	Pjesërisht	Në proces
Raportimi mbi zbatimin e masës								
2	C.7.2.1 Nxitja e organizimit të mësimin në distancë dhe “të nxëniet të kombinuar” është një hap i rëndësishëm në zhvillimin e arsimit në institucionet publike të arsimit të lartë. Për të mbështetur këtë iniciativë, Universiteti i Vlorës ka siguruar akses në platformat LMS, duke përfshirë G-Suite, e cila përmban Google Classroom dhe Google Meet, si dhe platformën LMS të Universitetit të Vlorës, e cila mund të aksesohen në linkun uvms.univlora.edu.al.							
	C.7.2.2 Për të siguruar përdorimin efikas të këtyre platformave, organizohen trajnime periodike për stafin akademik çdo fillim viti akademik. Gjithashtu, për çdo staf të ri, organizohen trajnime individuale për përdorimin e platformave LMS. Këto trajnimet kanë për qëllim të ndihmojnë stafin akademik të përvetësojë dhe shfrytëzojë mjetet e teknologjisë për të përmirësuar procesin mësimor. Manualët për përdorimin e këtyre platformave mund të gjenden në linkun https://univlora.edu.al/manuale/							
	Arsyet e mozbatimit (në rast kur masa nuk është zbatuar)							
Raportimi Financiar								
Shpenzimet/Alokimet			Buxheti i shtetit	Donatori/ët	Burime të tjera			
Shpenzimet financiare					191,999			
Alokimet e pritura								
Rekomandime:								
Nr. 3	Masa		Rezultatet e pritshme	Indikatorët	Niveli i zbatimit			
	C.7.3 Ofrimi i shërbimeve digjitale cilësore për studentët.	TM1 2022-TM4 2026 TM1 2023-TM4–2026	C.7.3.1 Sigurimi i aksesit në biblioteka digjitale. C.7.3.3 Digjitalizimi i sekretarive në të gjitha IAL-të publike.		E zbatuar	E pazbatuar	Pjesërisht	Në proces
Raportimi mbi zbatimin e masës								
3	C.7.3.1 Digjitalizimi i fondit është një proces i vazhdueshëm dhe i pandërprerë. Duke gjykuar nga kërkesat e studentëve, librat më të kërkuar prej tyre janë digjitalizuar dhe janë të përdorshëm nëpërmjet bibliotekës digjitale. Ndërkohë vazhdon procesi i digjitalizimit të materialeve të tjera. Procesi i digjitalizimit të sekretarive është bërë i mundur përmes sistemit online të UV. Kjo mundëson që studentët të realizojnë kërkesa dhe shërbime administrative përmes platformës elektronike të Universitetit të Vlorës, e cila është e aksesueshme në linkun uvms.univlora.edu.al. Ky sistem i automatizuar përmirëson efikasitetin dhe qartësinë e shërbimeve për studentët dhe stafin, duke i mundur një administratë më të shpejtë dhe të thjeshtuar.							
	Arsyet e mozbatimit (në rast kur masa nuk është zbatuar)							
Raportimi Financiar								
Shpenzimet/Alokimet			Buxheti i shtetit	Donatori/ët	Burime të tjera			

